

VENDIM
Nr.556, datë 28.5.2009

**PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT SHQIPTARË,
TË DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE REPUBLIKËN E AFRIKËS
QENDRORE, NË KUADËR TË MISIONIT USHTARAK “MINURCAT”, TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA**

(Ndryshuar me VKM nr. 12, datë 7.1.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10114, datë 9.4.2009 “Për miratimin e aktit normativ nr.1, datë 2.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e një kompanie të Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, në misionin “Minurcat”, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi ditor për ushtarakët shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, në misionin “Minurcat” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të jetë 9 000 (nëntë mijë) lekë për çdo ditë qëndrimi në këtë mision. Trajtimi financiar të fillojë nga data e dërgimit me mision të kontingjentit ushtarak.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 1 020 600 (një milion e njëzet mijë e gjashtëqind) euro, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha